



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.29, datë 17.03.2021

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“STRUKTURË ME FUNKSION HOTELERI 1, 2, 3, 4 KATE MBITOKË DHE 4 KATE
NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË DHËRMI, BASHKIA HIMARË”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Altea Invest” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Strukturë me funksion hoteleri 1, 2, 3, 4 kate mbitokë dhe 4 kate nëntokë”, me vendndodhje në Dhërmi, Bashkia Himarë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Altea Invest” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Vecantë, bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Himarë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 38, datë 03.12.2020 “Për miratim e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë polifunksionale “Strukturë me funksion hoteleri 1, 2, 3, 4 kate mbitokë dhe 4 kate nëntokë”, me vendndodhje në Dhërmi, Bashkia Himarë”, shfuqizohet.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDITHAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

